

VE NDIM
Nr. 675, datë 2.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 277, DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 17, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalja e parë, e pikës 4, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Masa e përfitimit për shkak të verbërisë është 12 092 (dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2020.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe